



Vlorë, Maj 2020
QENDRA RINORE E VLORËS

MONITORIMI I BASHKISË VLORË

NË LIDHJE ME MASAT E NDËRMARRA NË KUADËR TË PANDEMISË COVID – 19



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER



Suedi
Sverige

TABELA E PËRMBAJTJES

3 SHKURTIME

3 FALENDERIME

4 HYRJE

5 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

7 ANALIZË E GJETJEVE

Gjetjet bazuar në informacionet e ofruara nga Bashkia Vlorë

Gjetje nga monitorimi i vendimeve të këshillit bashkiak

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarët

13 REKOMANDIME

14 ANEKSE

Vendimet e Këshillit Bashkiak

Pyetësori që i është dërguar bashkisë

Ky raport është Përgatitur nga Qendra Rinore e Vlorës në kuadër të projektit POP 2020 "Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal" të mbështetur nga Olof Palme Centre International, përmes mbështetjes financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Suedeze ose të Olof Palme International Centre.

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë periudhës së izolimit prej pandemisë COVID-19, bashkëpunuam me shumë aktorë lokalë dhe institucione. Falenderojmë Bashkinë Vlorë, nën/kryetarin Jeton Puka, Drejtorinë e Ndihmës së Shërbimit Social, Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Informacionit, për përgjigjen e shpejtë brenda afatit kohor. Falenderojmë veçanërisht qytetarët dhe të rinjtë, grupet e interesit, biznese, gazetarë, që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona. Një falenderim shkon dhe për anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët kanë kontribuar për monitorimin dhe përgatitjen e raporteve të ngjashme të monitorimit në bashki të tjera ku rrjeti punon.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë Olof Palme International Center, për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin *"Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)"* në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Rrjeti *"Përballja e Ofertave Politike – POP"*, synon të rrisë debatin publik dhe përçojë informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: *"Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social"*. Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për "Zhvillimin e Shoqërisë Civile", Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- "Epoka e Re", Fier;
- Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër;
- "Lëvizja Rinore për Demokraci", Pukë;
- Qendra për Progres Rinor, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me *"Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal."* Gjatë fazës së parë të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimarrje.

Por, mes situatës së krijuar nga COVID-19, anëtarët e rrjetit POP përshtatën aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit që këto organizata përfaqësojnë.

Gjatë muajve mars dhe prill 2020, organizatat patën si qëllim:

- Të monitorojnë veprimtarinë e bashkive për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë dhe vendimet e Këshillave Bashkiakë.
- Të raportojnë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojnë dhe advokojnë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Metodologjia

Për përgatitjen e raportit të monitorimit janë kombinuar një sërë mjeteve dhe metodologjish që janë si më poshtë:

1. Në çdo bashki u dërgua një kërkesë për informacion. Përgjigjet e kësaj letre janë në pjesën e analizimit të gjetjeve.
2. U realizuan 60 intervista cilësore me qytetarë të grupeve në nevojë, komunitet egjiptian, të punësuar, të rinj, biznese/gazetarë lokale, që kontribuan në marrjen e mendimit qytetar.
3. U monitoruan komunikimet publike të përfaqësuesve të bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
4. U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak, në lidhje me masat e marra nga Bashkia për shërbime ndaj komunitetit, në përgjithësi dhe me disa target grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
5. Rishikim i legjislacionit dhe planit të masave të marra nga Qeveria dhe Pushteti Vendor për situatën COVID-19.

Përmbledhje Ekzekutive

Monitorimi mbi masat e ndërmarra dhe të implementuara në kuadër të pandemisë COVID-19, është realizuar gjatë periudhës mars-prill 2020, nga Qendra Rinore e Vlorës dhe përmban gjetjet për (i) Bashkinë Vlorë; (ii) vendimarrjen e Këshillit Bashkiak; (iii) intervista me qytetarë të ndikuar drejtpërdrejtë nga kjo situatë.

Gjetjet bazuar në informacionet e ofruara nga Bashkia Vlorë.

- Bashkia Vlorë aktivizoi Komisionin e Mbrojtjes Civile dhe grupet e vlerësimit në terren që bënë identifikimin e familjeve dhe individëve në nevojë.
- Informimi i qytetarëve është realizuar në mënyrë periodike përmes mediave lokale dhe mediave sociale online. Në dispozicion të qytetarëve janë vendosur 4 numra celulari të dedikuar si dhe kontaktet e kryetarëve të rajoneve dhe drejtorëve të drejtorive, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë.
- Në Bashkinë Vlorë, janë 789 familje (563 zonën urbane/ 226 zonat rurale), përfituese të ndihmës ekonomike (nga të ardhurat e bashkisë, fondi i kushtëzuar 6% dhe sistemi dixhital) për muajin shkurt, që në muajin mars 2020, në bazë të urdhërit nr.92/4 datë 27/03/2020, përfituan dyfish pagesën e ndihmës ekonomike.
- Janë ndihmuar me paketa të ndihmës ushqimore rreth 60 familje që janë pjesë e NE, si dhe përfitues të pagesës së Aftësisë së Kufizuar, nga të cilat 37 familje në zonat e thella rurale dhe 23 familje në qytet.
- Gjatë muajit mars 11 persona më shumë, përfituan pagesën e paaftësisë për punë (KEMP), në një total prej 1630 persona, nga të cilët 1157 jetojnë në zonë urbane dhe 473 në zonën rurale.
- 35 familje përfitojnë subvencionimin e qerasë (bonusi i qerasë) për muajin prill 2020.

- Për tremujorin e parë deri në fillim të muajit prill 2020, janë trajtuar nga Koordinatori Vendor i Njesisë së Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore, 22 raste të reja të dhunës në familje.
- 157 familje është numri i komunitetit rom dhe egjiptian në bashkinë e Vlorës të ndihmuar, nga të cilat 30 familje janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, bonusit të qerasë dhe pas datës 9 mars edhe 127 familje përfituan paketën e ndihmës ushqimore, konkretisht 67 familje rome në NJA Novoselë dhe 60 familje rome në NJA Shushicë.
- 11 individë me statusin e jetimit dhe 210 nëna kryefamiljare në Bashkinë e Vlorës, trajtohen me ndihmën financiare, ndërsa nuk ka të dhëna për ndihma të tjera.
- Bashkia ka asituar rreth 1000 të moshuar përmes ndihmës për të të blerë ushqimet, ofrimit të ilaçeve të rimbursueshme dhe ofrimi i pakove ushqimore.
- Shumë individë të papunë, gjatë izolimit janë drejtuar bashkisë Vlorë për përfitimin e pakove ushqimore, në muajt mars- prill, kërkesat janë administruar përmes rajoneve.
- Ndarja e ndihmave ushqimore, ka nisur më datë 25.03.2020 dhe brenda marsit janë shpërndarë 1340 pako ushqimore. Puna në terren ka rezultuar me riklasifikim të familjeve dhe për muajin prill janë miratuar pako të ndihmave për 1193 familje nga të cilat 693 të referuara nga sektori i Ndhmës Sociale dhe për 500 familje do të shpërndahen, pas verifikimeve rast pas rasti dhe aprovimit në Komisionin Qendror për Ofrimin e Asistencës.
- Pakot ushqimore përmbajnë ushqimet më të nevojshme dhe për muajin mars kishte vlerën 2,058 lekë/pako, në muajin prill janë shtuar edhe detergjentë dhe vlerësohet 3083 lekë/pako ushqimore.
- Bashkia është ndihmuar edhe nga donatorë privatë si Fundjava Ndryshe, Eurosig, Big Market, K.a Trading Albania Shpk, INSIG, Hipermarket Haso, Hotel Regina dhe disa njësi të vogla tregëtare, të cilat kanë shpërndarë ushqime në familjet e identifikuara nga administratorët e rajoneve dhe të pa trajtuar me fondet e vetë bashkisë. Donatorët privatë kanë mbuluar rreth 430 familje me ndihma, gjatë muajit mars.
- Në të dhënat e siguruara nga Bashkia Vlorë, për disa shërbime të ofruara, mungon ndarja gjinore. Nuk ka informacione në lidhje me numrat dhe shërbime drejtuar të rinjve në izolim.

Gjetje nga monitorimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak të Vlorës.

- Këshilli Bashkiak i Vlorës gjatë izolimit për shkak të COVID-19, ka marrë vendime nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (email), në bazë të aktit normativ nr. 03 datë 15.03.2020, neni 5.
- Gjatë periudhës mars-prill 2020, janë realizuar 4 mbledhje përmes komunikimit me email dhe janë marrë në total 11 vendime nga të cilat 6 vendime të lidhura me gjendjen e COVID-19.
- Në periudhën e distancimit social, Këshilli Bashkiak i Vlorës, përmes realizimit të mbledhjeve me email, ka aprovuar 4 rregullore të rëndësishme të funksionimit dhe organizimit të tij.
- Ka munguar komunikimi në mediat lokale ose mediat sociale, për vendimarrjen në situatën e COVID-19, ndërsa vendimet e Këshillit në faqen e Bashkisë janë të publikuara deri në shkurt 2020 dhe faqja e FB është pa informacione rreth kësaj teme.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë.

- Ka ankesa për të drejtat e lëvizjes ose shërbime që ofrohen ekskluzivisht nga bashkia, jo të gjitha planet e masave dhe aktet e miratuara, kanë qënë të deklaruara nga institucionet vendore.
- Komunikimi përmes rrjeteve sociale përbën bazën e komunikimit, duke anashkaluar mediumet publike që ka për detyrë bashkia, t'i bëjë publike ndaj qytetarëve.
- Përsa i përket ndihmës ekonomike dhe ushqimore, qytetarët shprehen se Bashkia ka shumë pak mundësi ti ndihmojë dhe shprehen se nuk kanë mundësi të përfitojnë edhe nëse aplikojnë në periudhën e izolimit, ose pas saj.
- Pensionistët deri diku shprehen pozitivë ndaj vëmendjes së treguar për ta, ata konfirmojnë se disa shërbime i marrin nga bashkia, por kanë gjetur dhe mbështetje nga të afërm të tyre.
- Komuniteti rom dhe egjiptian, mbetet në kërkim të vazhdueshëm të mbështetjes ushqimore dhe financiare, ata përballen me vështirësi të mëdha.
- Nga intervistat e realizuara me grupe të ndryshme qytetarësh shprehet qartë pasiguria dhe shqetësimi mbi situatën e vështirë ekonomike që janë duke përjetuar. Familjet në nevojë, që trajtohen me ndihmë financiare dhe pako ushqimore, kërkojnë që informacioni të mbërrijë në kohë dhe mbështetja të jetë e vazhdueshme.
- Të punësuarit në sektorin e shërbimeve, nuk kanë informacion nëse do të arrijnë të përfitojnë ndihmën financiare të vendosur nga Qeveria Qendrore, por më shumë janë të shqetësuar nëse do të kenë mundësi të rikthehen në punë, pas përfundimit të periudhës së izolimit.
- Sektori i biznesit, manifeston shqetësime rreth impaktit ekonomik dhe social, jo vetëm në aktivitetin e tyre, por për gjithë bashkëpunëtorët dhe partnerët e tyre. Të gjithë janë të mendimit se kjo periudhë e izolimit do të sjellë ndikime afatgjata. Edhe pse janë në djeni të masave lehtësuese dhe disa prej tyre kanë përfituar, ata rekomandojnë mbështetje më të madhe nga qeverisja qendrore dhe ajo lokale.
- Ndërsa nxënësit dhe studentët, janë më pak të shqetësuarit, por manifestojnë lodhje me procesin e të mësuarit online, probleme emocionale dhe sociale, që mbeten ende pa u trajtuar në periudhën e izolimit.

Analizë e gjetjeve

Raportim bazuar në informacionet e ofruara nga Bashkia Vlorë.

Izolimi u pasqyrua me një situatë të pazakontë, për këtë arsye Bashkia e Vlorës ka zhvilluar gjithë detyrat dhe funksionet e deleguara nga Qeveria Qendrore. Në bazë të urdhërit 105, datë 24.02.2020, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave si dhe grupet e vlerësimit në terren. Me zhvillimet e shpejta të situatës, kanë dalë urdhëra dhe dokumente mbështetëse për plotësimin dhe ndarjen e detyrave të Komisionit të Mbrojtjes Civile.

Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga Qeveria Shqiptare, shoqëruar me izolim të detyrueshëm, për të ndihmuar në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit gjatë pandemisë COVID-19, Bashkia e Vlorës ka kufizuar shumicën e shërbimeve jo thelbësore ndaj qytetarëve dhe ka ndërprerë ose shtyrë takimet publike. Ndërsa një pjesë e rëndësishme e shërbimeve ofrohen edhe online siç janë: vërtetime të ndryshme, autorizime për lëvizjen e mjeteve, lejet e ndërtimit, etj.

Shërbime publike thelbësore të tilla si furnizimin publik me ujë të pijshëm; mënjanimi i ujërave të ndotura dhe mbeturinave; ruajtja e kushteve tekniko-sanitare dhe higjienike në ndërtesa publike dhe jopublike; sigurimi i gjendjes së rregullt sanitare të artikujve ushqimorë dhe të kushteve higjienosanitare (tregjet publike); aplikimi i lëndëve biocide (dezifektim), me karakter parandalues, në qendrat e banuara, hapësirat publike, objektet për furnizim me ujë të pijshëm, në objektet dhe mjetet e transportit publik; informimi, komunikimi, promovimi i shëndetit dhe edukimi i vazhdueshëm shëndetësor i personelit, si dhe i popullatës; janë ende duke u ofruar me funksionalitet të plotë.

Përgjatë muajit mars janë ndërmarrë masa shtesë për shërbimin e dezifektimit të specializuar, nëpërmjet dezifektimit të gjithë kopshteve, shkollave, ambiente të administراتës, rrugë, sheshe dhe ambiente të përbashkëta.

Në zbatim të masave të marra si pasojë e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe VKM nr. 236, datë 19.03.2020, Bashkia Vlorë, miratoi më datë 23.03.2020 me vendim të Këshillit Bashkiak Vlorë, nr. 28, datë 23.03.2020, rialokim të fondeve dhe përdorimin e tyre, për ndihmën ndaj familjeve të shtresave në nevojë, si pasojë e situatës së shkaktuar nga COVID-19, duke miratuar një fond prej 3.087.000 lekë për dhënien e ndihmave ushqimore ndaj 1500 familjeve, sipas listës së përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Administratorët e Njësive.

Personat me aftësi të kufizuara, pensionistë të vetmuar, familje apo individë në nevojë, komuniteti rom dhe egjiptian, familje me më shumë se 5 anëtarë dhe përfitues të ndihmës ekonomike, përbëjnë grupet në nevojë të asistuar drejtëpërdrejtë nga Bashkia, përmes shpërndarjes së pakove ushqimore. Pjesë e kësaj liste ishin 789 familje/individë përfitues të ndihmës ekonomike dhe 711 pensionistë të vetmuar ose familje në vështirësi nga qyteti dhe zonat rurale. Identifikimi i familjeve dhe individëve në nevojë, filloi përmes krijimit të grupeve të vlerësimit të përbërë nga kryetari i rajonit, punonjës social, punonjës të policisë bashkiake dhe vullnetar, që kanë evidentuar gjendjen ekonomike dhe shpërndarë pakot ushqimore.

Në Bashkinë Vlorë, janë 789 familje (563 zonen urbane/ 226 zonat rurale), përfituese të ndihmës ekonomike për muajin shkurt, që trajtohen nga të ardhurat e bashkisë, fondi i kushtëzuar 6% dhe sistemi dixhital, të cilët për muajin mars 2020, në bazë të Urdhrit nr.92/4 datë 27/03/2020, përfituan dyfish pagesën e ndihmës ekonomike.

Gjithsej nr. i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në Bashkinë Vlorë	Në qytet	Në Nj.A
789 Familje	563 familje	226 familje

Në lidhje me marrjen e shërbimeve përkatëse të Personave me Aftësi të Kufizuar nga Bashkia Vlorë, janë ndihmuar me paketa të ndihmës ushqimore rreth 60 familje që janë edhe pjesë e skemës dixhitale të NE, si dhe përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar. Për individët nga zonat e thella rurale dhe konkretisht: në NJA Shushicë janë ndihmuar 20 familje të cilët kanë në përbërjen e tyre familjare Persona me Aftësi të Kufizuar. Në NJA Oriku 5 familje, në NJA Novoselë 7 familje dhe në NJA Qendër 5 familje. Gjithashtu në bazë të VKM nr.254 datë 27/03/2020 janë trajtuar me paketa ushqimore 9 persona me aftësi të kufizuar të cilët jetojnë të vetëm.

Gjatë muajit mars 11 persona më shumë, përfituan pagesën e paaftësisë për punë (KEMP), në një total prej 1630 persona, nga të cilët 1157 jetojnë në zonë urbane dhe 473 në zonën rurale. Informacion për ndarjen gjinore në zonat urbane janë 655 burra dhe 502 gra. Në rastet kur kohëzgjatja e KMACP ka përfunduar në këtë periudhë dhe kërkohet ribërja e dokumentave nga e para, nuk është penalizuar dhënia e pagesave për këtë kategori.

Nr. i personave që trajtohen me KEMP	Burra qytet	Gra qytet	Jetojnë në zonë urbane	Jetojnë në zonë rurale
1630	655	502	1157	473

Në Bashkinë Vlorë, përmes procesit të aplikimit 30 familje përfitojnë subvencionimin e qerasë (bonusi i qerasë), për muajin mars dhe prill 2020. Statusi i pastrehë ofrohet për përfituesit e subvencionimit të qerasë në tregun e lirë që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme, si: Familje me një prind që trajtohen me NE, individë PAK, familje të komunitetit egjiptian, familje me një prind viktimë e dhunës, etj. Invalidët dhe përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike përfitojnë subvencionim maksimal të barabartë me vlerën e qerasë. Ndërsa për kategoritë e tjera në nevojë, vlera e subvencionimit përcaktohet në bazë të kriterëve të legjislacionit në fuqi.

Për tremujorin e parë dhe fillimin e muajit prill 2020, janë trajtuar nga Kordinatori Vendor i Njësisë së Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore 22 raste të reja të dhunës në familje, një prej të cilëve me ndërhyrjen e përbashkët të Grupit Teknik Ndërdisciplinor. Janë vlerësuar edhe 3 raste që janë pajisur me urdhër mbrojtje prej vitit 2019. Çdo rast dhune i paraqitur pranë drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social ose çdo rast i referuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë është kontaktuar dhe është bërë vlerësimi i nevojave nëpërmjet një intervistimi mes koordinatorit të dhunës dhe viktimës. Pasi është vlerësuar nevoja e çdo rasti dhune, koordinatori ka informuar viktimën dhe e ka referuar në institucionet përkatese. Vijon i njëjti trend i rasteve si një vit më parë me diferenca të vogla në zbritje.

Nr. Raportime të dhunës në familje	Burra	Statusi i martuar/i divorcuar/ i ve/ beqar me fëmijë)	Gra	Statusi (e martuar/e divorcuar/ e ve/ beqare me fëmijë)	Jetojnë në zonë urbane/ rurale
Janë trajtuar 25 raste të dhunës në familje.	2	1 martuar/ beqar	23	Fasha më e madhe është e martuar	Fasha më e madhe jetojnë në zone urbane

Burimi: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social

Në lidhje me masat e marra për komunitetin Rom dhe Egjiptian pas datës 9 Mars 2020, nga përgjigja e bashkisë referohet se 157 familje është numri i këtij komuniteti në Bashkinë e Vlorës, të ndihmuar me pako ushqimore, nga të cilët 30 familje janë pjesë e skemës së NE, bonusit të qerasë. Në dy NJA Novoselë dhe Shushicë, janë ndihmuar me paketa ushqimore, jo vetëm përfituesit e ndihmës ekonomike por i gjithë komuniteti rom, konkretisht 67 familje rome në NJA Novoselë dhe 60 familje rome në NJA Shushicë.

Nr. i familjeve Rome e Egjiptiane	Jetojnë në zonë urbane	Njësia administrative
157	30 familje jetojne në zonë urbane	127 familje

Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, shoqëruar me izolim të detyrueshëm, janë identifikuar persona të moshës së tretë që jetojnë vetëm dhe i kanë fëmijët jashtë vendit. Sipas të dhënave të cilat nuk janë përfundimtare, Bashkia ka asituar rreth 1000 të moshuar, përmes ndihmës për të të blerë ushqimet, ofrimit të ilaçeve të rimbursueshme dhe pako ushqimore. Nuk ka të dhëna për ndarjen gjinore sepse grupet teknike janë në terren për të ofruar ndihmë.

Sipas Zyrës së Shërbimit Social dhe NE, 11 individë me statusin e jetimit dhe 210 nëna kryefamiljare në Bashkinë e Vlorës, trajtohen me ndihmë financiare, ndërsa nuk ka të dhëna për ndihma të tjera.

Shumë individë të papunë ose në gjendje të vështirë ekonomike, gjatë izolimit i janë drejtuar Bashkisë Vlorë për përfitimin e pakove ushqimore, sidomos gjatë muajit prill, që janë administruar përmes personelit të rajoneve. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin dhe ndarjen gjinore dhe nëse kanë përfituar ndihmë, ndërsa Bashkia konfirmon se bashkëpunon me Zyrën e Punës për referimin e forcës së aftë për punë.

Pyetjes mbi familjet që kanë marrë ndihma dhe zonat ku janë shpërndarë, përfaqësues të bashkisë përgjigjen se: Ndarja e ndihmave ushqimore, ka nisur më datë 25.03.2020 dhe brenda marsit janë shpërndarë 1340 pako ushqimore, nga 1500 pako ushqimore të planifikuara, 160 familje pas verifikimeve u konstatua se nuk plotësonin kriteret dhe nuk iu shpërndanë. Në muajin prill është përgatitur lista e 160 familjeve me mbi 6 anëtarë që trajtohen me ndihmë ekonomike ose fondi i 6%. Puna në terren ka rezultuar me riklasifikim të familjeve dhe për muajin prill janë miratuar pako të ndihmave për 1193 familje nga të cilat 693 të referuara nga sektori i Ndihmës Sociale dhe për 500 familje do të shpërndahen nga administatorët e rajoneve, pas verifikimeve rast pas rasti dhe aprovimit në Komisionin Qendror për Ofrimin e Asistencës.

Pakot ushqimore përmbajnë ushqimet më të nevojshme dhe në muajin mars kishte vlerën 2,058 lekë/pako, ndërsa në muajin prill janë shtuar edhe detergjentë, me vlerën 3083 lekë/pako ushqimore.

Bashkia është ndihmuar edhe nga donatorë privatë si Fundjava Ndryshe, Eurosig, Big Market, K.a Trading Albania Shpk, INSIG, Hipermarket Haso, Hotel Regina dhe disa njësi të vogla tregëtare, që kanë shpërndarë ushqime për familjet e identifikuar nga administatorët e rajoneve dhe të pa trajtuara me fondet e vetë bashkisë. Donatorët privatë kanë mbuluar rreth 430 familje me ndihma dhe vlerësohen maksimalisht për ndihmën e tyre.


Në të dhënat e siguruara nga Bashkia Vlorë, për disa shërbime të ofruara, mungon ndarja gjinore. Gjithashtu nuk ka informacione në lidhje me numrat dhe shërbime drejtuar të rinjve në izolim.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarët

Gjatë periudhës 20-30 prill 2020, janë intervistuar 60 persona nga kategori të ndryshme qytetarësh, (40 në zonën urbane/20 në zonat rurale), përmes komunikimit telefonik. Intervistat janë fokusuar në shërbimet që qytetarët marrin nga Bashkia, por janë kërkuar edhe mendime si mund të formulohen shqetësimet e tyre në rekomandime për ndryshimin e situatës.

Nga grupet e intervistuar shqetësime më të mëdha, shfaqin kategoritë e familjeve në nevojë, komuniteti rom dhe egjiptian, pensionistët dhe të punësuarit (kryesisht punonjës të sektorit privat), ndërsa grupet e tjera kërkojnë informacion më të detajuar rreth masave aktuale dhe shfaqin pasiguri për të ardhmen pas periudhës së izolimit.

Intervista me kategori të ndryshme qytetarësh



Në lidhje me kategorinë e familjeve në nevojë, (4 në 10 familje të intervistuar), kryesisht ata të përfshirë në skemën e NE, referojnë se kanë marrë mbështetje financiare dhe ushqimore nga Bashkia Vlorë. Pas verifikimit të grupeve të Bashkisë, mbështetja financiare është dyfishuar gjatë muajit mars, presin dhe për prillin të njëjtën shumë, ndërkohë që kanë marrë dhe pako ushqimore. Gjithsesi ata shprehen mjaft të shqetësuar për situatën ekonomike ku ndodhen dhe kërkojnë mbështetje të vazhdueshme për ta.

Për familjet që nuk janë përfshira në skemën e ndihmës ekonomike (6 nga 10 të intervistuar), më të shqetësuar janë familjet me mbi 5 anëtarë, që kryesisht nuk kanë marrë asnjë lloj ndihme e sidomos, pako ushqimore nga Bashkia. Kërkesat e tyre kanë qënë bazike duke kërkuar mbështetje ushqimore, në disa raste dhe pagesa të faturave të dritave dhe ujit. Gjatë intervistave përfaqësues të kësaj kategorie janë shprehur se nuk janë kontaktuar, nga grupet e verifikimit të bashkisë në muajin mars, ndërkohë që në prill janë drejtuar vetë drejt rajoneve, Bashkisë dhe Prefekturës, disa prej tyre kanë shkruar dhe në portalin e bashkëqeverisjes, por ende nuk kanë marrë ndonjë ndihmë. Ata kanë konfirmuar që kërkesat e tyre janë administruar kryesisht nga punonjësit e rajoneve, por mbeten ende në pritje dhe një pjesë e tyre deklarojnë se për ta, nuk po bëhet asgjë.

Përsa i përket komunitetit rom & egjiptian. Kryesisht të intervistuar janë familje nga komuniteti egjiptian në qytet dhe rom në NJA. Ata shprehen shumë të shqetësuar, periudha e izolimit i ka detyruar të mos kenë mundësi të punojnë dhe janë në kushte mbijetese.

Ata referojnë se e kanë të ndaluar të dalin nga shtëpitë e tyre, nuk punojnë dot, ushqehen duke marrë pa paguar ushqimet në dyqanet e lagjeve, kërkojnë detergjentë dhe mjete mbrojtëse. Kërkesat e tyre janë për ndihma ushqimore për familjet e tyre, ndërkohë që referojnë se janë drejtuar në bashki për të përfituar pako ushqimore. Në disa raste të intervistuarit raportojnë se kanë marrë ndihma si miell, ose pako ushqimore nga Fundjava Ndryshe, edhe Bashkia. Gjithsesi edhe kjo kategori kërkon për t'u ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme.

Pensionistët shprehen se kanë marrë shërbim nga Bashkia, janë kontaktuar përmes telefonit ose nga grupet e verifikimit nëse kishin nevojë për ndihmë. Ata shprehen mjaft të shqetësuar për situatën që janë duke kaluar edhe pse rregullat e karantinës nuk i zbatojnë gjithmonë. Problematike është situata për pensionistët e vetmuar, që kanë edhe probleme shëndetësore dhe një pjesë e tyre janë asistuar me medikamente të skemës së rimbursimit, përmes kërkesave që kanë bërë në numrat e kontaktit të bashkisë, por janë ndihmuar edhe nga të afërm dhe komshinj. Probleme raportojnë të moshuarit në Nj.A të Novoselës dhe Qendër, ku nuk ofrohet i njëjti shërbim si në qytet, për shkak të numrit të limituar të punonjësve të bashkisë dhe largësisë së fshatrave nga njëri-tjetri. Kryesisht këta të moshuar janë ndihmuar nga fqinjët dhe në disa raste i kryejnë vetë shërbimet e nevojshme. Ndërkohë që pensioni u vjen në shtëpi nga shërbimi postar.

Një grup i rëndësishëm i kontaktuar, janë edhe të punësuarit në sektorin privat, kryesisht të punësuar në sektorin e shërbimeve, që janë ndikuar drejtëpërdrejtë nga situata. Ata nuk e dinë nëse do të jenë ende, në një marrdhënie pune, pas përfundimit të izolimit të COVID-19 dhe mungesa e informacionit dhe pasigurisë për të ardhmen është e evidente në të gjitha intervistat e realizuara. Në lidhje me paketat e ndihmës financiare, për të punësuarit në subjektet e biznesit të vogël dhe të madh, ata raportojnë se kanë pak informacione nëse janë apo jo përfitues, në pjesën më të madhe të rasteve, kanë dorëzuar numrat e llogarive bankare, por nga 10 të intervistuar deri në fund të prillit vetëm 2 kishin përfituar pagesat. Gjithsesi pjesa më e madhe e tyre, shprehen se edhe nëse nuk përfitojnë "pagat e luftës", e rëndësishme për ta është të kthehen prapë në punë, kur të mbarojë periudha e izolimit. Shqetësimi për gjendjen ekonomike gjatë dhe pas pandemisë, rrit ndjeshëm pasojat për këtë kategori.

Bizneset e intervistuar, përfaqësojnë shqetësimet e gjithë sektorit, për gjendjen aktuale, por edhe atë që do të ndodhë më vonë. Administratorët e kontaktuar referuan se ndodhen në një situatë shumë të vështirë. Mbyllja e bizneseve i detyroi që të hiqnin një pjesë të personelit nga puna, (3/10), sepse nuk kishin informacion të qartë për masat mbështetëse të ndërmarra nga Qeveria Qendrore. Të gjithë bizneset e intervistuar deklarojnë se kanë aplikuar për mbështetje financiare për pagesat e personelit, por disa prej tyre konfirmojnë, se kishin probleme për përfitimin e mbështetjes dhe u është dashur ti ribëjnë aplikimet. Gjithsesi vetëm 4/10 konfirmojnë që në fund të prillit, kanë marrë pagesat nga Ministria e Financave, pjesa tjetër janë në pritje. Disa prej tyre janë lejuar të rifillojnë aktivitetin, por shprehen mjaft të shqetësuar nëse do të arrijnë të mbijetojnë pas përfundimit të periudhës së izolimit. Një pjesë e tyre, edhe pse kanë rifilluar punën, nuk kanë mundësinë të zhvillojnë aktivitetin, për shkak të kufijve të mbyllur dhe pezullimit të kontratave që kanë me Italinë. Bizneset që punonjë në sektorin e turizmit shprehen se të gjitha kontratat u janë anuluar dhe shpresojnë në lehtësimin e masave, në mënyrë që turistët vendas ta frekuentojnë sa më shumë Vlorën. Gjithësesi të gjitha bizneset shprehen se i pret para, një vit shumë i vështirë, i shoqëruar me pasiguri për të ardhmen.

Nxënës dhe studentë raportojnë se nuk janë të ndikuar ekonomikisht nga situata e izolimit, por shprehin lodhje për procesin mësimor që janë duke ndjekur. Mësimi zhvillohet përmes telefonit, kanalit të RTSH-së dhe kanalit në You Tube të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjetjet e intervistave konfirmojnë se shumë të rinj janë të shqetësuar për izolimin dhe si do të jetë rikthimi në jetën e normale pas tij. Izolimi social ka ndikuar në shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Të rinjtë e intervistuar konfirmojnë se vazhdojnë të gjejnë mënyra të reja si të organizojnë procesin mësimor dhe atë argëtues, gjatë qëndrimit në shtëpi, por ata janë të shqetësuar rreth impaktit të COVID-19 në jetën e tyre. Asnjë shërbim i drejtëpërdrejtë nuk ofrohet për këtë kategori, për ta mendon vetëm familja. Nevojiten zgjidhje inteligjente nga vendimarrësit dhe familjet, që të rinjtë të integrohen në procesin edukativ, por edhe të mos preket mireqenia e tyre.

Rekomandime

- Situata e izolimit dhe pandemisë së COVID-19, vendosi institucionet dhe qytetarët para sfidave që kërkojnë ndërhyrje të shpejtë, të koordinuar dhe inteligjente.
- Bazuar mbi situatën, kërkohet zgjidhje dhe adresim i unifikuar për periudhën e daljes nga izolimi, ku komunikimi në kohë reale dhe bashkëpunimi mes qytetarëve dhe Bashkisë Vlorë, të jetë sa me cilësor dhe efektiv.
- Bashkia duhet të ndryshojë buxhetin e vitit 2020, fondet duhen të përshaten dhe të ri shpërndahen, për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe qytetarëve që rrezikojnë të mbeten të papunë pas periudhës së izolimit.
- Gjithë të dhënat e grumbulluara mbi qytetarët që kanë nevojë për mbështetje, nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Administratorët e Njësive dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile, duhet të unifikohen dhe orientohen drejt përgjigjes së shpejtë me ndihmë financiare ose ushqimore. Rekomandohet të krijohet një fond i nevojshëm për të adresuar me ndihmë financiare/usqimore, këto kategori.
- Rritja e mbështetjes për komunitetin rom dhe egjiptian përmes paketave ushqimore.
- Shërbimet që mund të ofrohen online për qytetarët, janë të rekomanduara të fuqizohen dhe të përdoren formate sa më të thjeshta. Bashkia duhet të investojë për mediumet zyrtare të shpërndarjes së informacionit, sic është faqja zyrtare e internetit, ku qytetarët të marrin informacion dhe shërbime në kohë reale.
- Edhe pse Bashkia nuk është përgjegjëse e drejtëpërdrejtë për punësimin e qytetarëve, ajo duhet të ketë në vëmendje, përmes ngritjes së iniciativave për punësimin e individëve që do të preken nga kriza e COVID-19.
- Mbështetje për sektorin e turizmit, përmes lehtësimit të taksave dhe tarifave, krijimit të mjedisit të sigurt për përdoruesit dhe iniciativave bashkëpunuese, në fuqizimin e sektorit që mbështet gjithë ekonominë qarkulluese në Bashkinë Vlorë.
- Mbështetje emocionale, artistike dhe kreativiteti, për fëmijët dhe të rinjtë, përmes programeve të aktiviteteve online.

Vendimet e Këshillit Bashkiak

Gjatë periudhës mars – prill 2020, janë realizuar 4 mbledhje përmes komunikimit me email dhe janë marrë në total 11 vendime nga të cilat 6 vendime të lidhura me gjendjen e COVID-19.

Në bazë të aktit normativ nr. 03 datë 15 mars 2020, neni 5: "Marrja e vendimeve nga organet kolegjiale gjatë kohëzgjatjes së COVID-19, realizohet edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik", Këshilli Bashkiak i Vlorës ka marrë vendimet e mëposhtme:

Vendimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vlorë më datë 23/03/2020:

- 1) Vendim për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2020.** Përfitojnë ndihmë ekonomike 48 familje me kushte shumë të vështira social-ekonomike, me një fond prej 138.900 lekë.
- 2) Vendim për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin shkurt 2020.** Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Shkurt 2020, gjithësej 9 familje me një fond prej 19.060 lekë.
- 3) Vendim mbi përdorimin e fondeve të Bashkisë Vlorë për ndihmën ndaj familjeve të shtresave në nevojë, si pasojë e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19:**
 - a) Dhënien e ndihmave ndaj 1500 familjeve të shtresave në nevojë, si pasojë e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, bazuar në listat bashkëlidhur që disponon Sektori i Ndhmës Sociale në Bashkinë Vlorë në bashkëpunim me Rajonet/Njësitë Administrative.
 - b) Ndihamat kanë vlerën prej 2,058 lekë/familje me një fond total prej 3,087,000 lekë dhe do të përmbajnë produktet e shportës ushqimore.
 - c) Fondet që do të nevojiten për realizimin sipas pikës 1 dhe 2, do të mbulohen nga fondet e miratuara me VKB nr.114 datë 27.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2020" për furnizimin me ushqime të kopshteve dhe çerdheve, duke u bërë ndryshimi i destinacionit të përdorimit të ushqimeve.

Vendimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak më datë 1/04/2020.

- 1) Miratimin e Kodit të Sjelljes dhe të Rregullave për Parandalimin e Konfliktit të Interesave të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë".**
- 2) Për miratimin e Rregullores për Marrëdhëniet e Këshillit të Bashkisë Vlorë me Publikun dhe me Median"**

Vendimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak më datë 10/04/2020

- 1) Vendim për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin mars 2020.** Përfitojnë ndihmë ekonomike 51 familje me kushte shumë të vështira social- ekonomike, për muajin Mars 2020, me një fond prej 298.600 lekë.

Vendimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak më datë 20/04/2020

- 1) Miratimi i Rregullores për Shqyrtimin dhe Miratimin e Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare.**
- 2) Miratimi i Rregullores për Strukturat Komunitare dhe Ndërveprimi i tyre me Këshillin e Bashkisë**
- 3) Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin mars 2020.**
 - 1) Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Mars 2020 gjithsej 10 familje me një fond prej 23.696 (njëzetë e tre mij e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.
- 4) Miratimi i fondeve të Bashkisë Vlorë për ndihmën ndaj familjeve të shtresave në nevojë si pasojë e situatës të shkaktuar nga COVID-19.**
 - 1) Të miratohet dhënia e ndihmave ndaj familjeve në nevojë, si pasojë e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, sipas përcaktimit të mëposhtëm:
 - a. Për 693 familje bazuar në listat që disponon Sektori i Ndihmës Sociale në Bashkinë Vlorë.
 - b. Për 500 familje të grupeve në nevojë bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM nr. 236 datë 19.03.2020, pas verifikimeve nga grupet e punës dhe miratimit të listës nga Komisioni Qendror për Ofrimin e Asistencës
 - 2) Ndihamat do të kenë vlerën 3083 lekë/familje me një fond total 3.678.019 lekë.
 - 3) Çmimi i produkteve do të bazohet në cmimet/njësi të kontratës së prokuruar nga Bashkia Vlorë për vitin 2020, për furnizimin me ushqime për kopshtet dhe çerdhet dhe furnizimin me detergjentë të prokuruar për 2019.

Pyetësori që i është dërguar bashkisë

Nr. 5/1 Prot

Vlore, më 7.4.2020

KËRKESË PËR INFORMACION Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, "Për të Drejten e Informimit"

Drejtuar: Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë Vlorë.

Lënda: Kërkesë për Informacion në lidhje me masat e marra për popullsinë në zonat rurale dhe urbane të Bashkisë Vlorë, në situatën e pandemisë COVID- 19.

I nderuar Z. Leli!

Uroj të jeni mirë me shëndet e punë. Ju ndjekim vazhdimisht në punën tuaj të përditshme dhe ju përgëzojmë për gjithshçka jeni duke bërë për Bashkinë tonë në përgjithësi e në këtë periudhë të vështirë të pandemisë për shkak të COVID-19.

Duke marrë parasysh situatën aspak të zakonitë që bota në përgjithësi dhe Shqipëria në veçanti po kalon prej pandemisë COVID-19, organizatat e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP), të krijuar gjatë zgjedhjeve Parlamentare 2013 janë duke monitoruar situatën e qasjes së pushtetit vendor pranë komunitetit në 9 bashki të vendit si dhe mbledhjet e Këshillave Bashkiakë dhe vendimet e tyre. Bashkia e Vlorës, monitorohet nga Qendra Rinore e Vlorës (në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Rinisë).

Me masat e marra nga qeveria shqiptare në lidhje me përballimin sa më të mirë të kësaj situate, një zë të veçantë ka edhe mbështetja për komunitetin dhe grupet në nevojë, qoftë kjo mbështetje ekonomiko - financiare, shëndetësore apo sociale. Në këtë kuadër, ne do të përgatisim në fillim të muajit maj 2020 një raport i cili do të përfshijë hapat e marra nga bashkia për zbatimin e vendimeve të Qeverisë Shqiptare dhe rekomandime nga ne për shërbimet e ofruara.

Bazuar në këto masa dhe në zbatimin e tyre pranë komunitetit të Bashkisë Vlorë, do ju luteshim të na informoni bazuar në pyetjet e mëposhtme:

- Sa familje në zonat rurale e urbane janë trajtuar me Ndihmë Ekonomike në Vlorë, gjatë muajit shkurt? A ka patur ndryshime në shtimin e rasteve të familjeve me ndihmë ekonomike pas datës 9 Mars dhe sa është numri i përfituesve? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë që familjet dhe individët e trajtuar nga bashkia juaj, janë identifikuar në territor me probleme të tjera si p.sh. familje me persona me aftësi të kufizuara, fëmijë me autizëm apo tjetër.

- Sa persona, të ndarë sipas gjinisë dhe zonës rurale apo urbane trajtohen me pagesën e paaftësisë për punë (KEMP) të dalë nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMACP) të invalidëve. A ka patur shtim të tyre pas datën 9 Mars 2020? Në rastet kur kohëzgjatja e KMACP ka përfunduar në këtë periudhë dhe kërkon ribërjen e dokumentave nga e para si është vepruar, a e ka penalizuar në vazhdimin e dhënies së pagesave për këtë kategori? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë, nëse po sa burra e gra janë?
- Sa familje në zonat rurale e urbane, përfitojnë përfitim bonus qeraje? A është shtuar numri i tyre pas datës 9 Mars 2020?
- A keni patur e trajtuar raste të dhunës në familje gjatë muajit mars dhe këtë fillim prilli 2020? Nëse po sa raste keni patur? Si është trendi i kësaj periudhe krahasuar me një vit më parë?
- Cilat janë masat e marra për komunitetin Rom dhe Egjiptian pas datës 9 Mars 2020? Sa është numri i familjeve Rome e Egjiptiane, ku janë vendosur ata në Bashkinë Vlorë dhe kush janë përfitimet që ata marrin nga Bashkia.
- Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga Qeveria Shqiptare shoqëruar me izolim të detyrueshëm, a keni identifikuar persona të moshës së tretë që jetojnë vetëm dhe i kanë fëmijët jashtë vendit? Sa është numri i tyre i ndarë sipas gjinisë? Cilat janë masat që ka marrë Bashkia Vlorë për këtë kategori?
- Sa është numri i individëve me statusin e jetimit të ndarë sipas gjinisë, që jetojnë në Vlorë? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Sa vajza nëna ka në Bashkinë Vlorë? Në cilat njësi administrative janë të vendosura? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia? Nëse Po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Gjatë identifikimit në territor me grupet e punës a keni ofruar ndihmë për individët e papunë, sa nga keta janë burra dhe sa gra dhe cila është ndihma e ofruar? Keni informacion sa është shtuar numri i tyre pas vendosjes së izolimit/vetëkarantimit prej situatës COVID-19.
- Në sa familje keni dërguar ndihma dhe në cilat zona e fshatra? Sa është rritur numri i familjeve që kanë nevojë për ndihma pas datës 9 Mars, 2020. Çfarë përmbajnë këto ndihma? Sa është sasia normale për një familje dhe si dhe sa here bëhet shpërndarja e tyre?
- A ka patur ndryshim të buxhetit të Bashkisë Vlorë pas vendosjes së masave të marra për situatën COVID-19. Nëse jo, si po përballohet kjo situatë nga Bashkia dhe nëse po si dhe ku janë reflektuar këto ndryshime?
- Referuar kategorisë së të rinjve, a ka ndonjë masë ose kërkesë specifike të ndërmarrë nga Bashkia Vlorë? Çfare shërbimi po ju ofrohet atyre?
- Cilat janë mjetet dhe mënyrat që komunikoni me qytetarët në njësi administrative dhe në qytet për shërbimet që ofroni gjatë periudhës së izolimit/vetëkarantinimit të detyrueshëm?
- Ju lutem na vini në dispozicion vendimet e Këshillit Bashkiak pas datës 9 Mars 2020.

Ne kemi përgatitur disa tabela të vendosura në aneks të kësaj letre që mund të ndihmojë për mbledhjen e informacionit. Për sa më sipër, sipas kategorive do ju luteshim që të na dërgoni statistikat përkatëse dhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes së masave në këtë kuadër.

Gjithashtu, donim t'ju vinim në dijeni se përpara zgjedhjeve lokale të Qershorit 2019, organizata jonë dhe Bashkia Vlorë, keni nënshkruar Kontratën Sociale, e cila përmban disa prioritete të cilat janë informuar në aktivitetet tona nga qytetarët e Vlorës. Ne jemi të bindur që ju keni punuar gjatë 2019 dhe po punoni në 2020 për ti realizuar ato, megjithë fatkeqësitë e mëdha natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe COVID-19. Në lidhje me Kontratën Sociale dhe zbatimin e saj ne do të bëjmë një tjetër kërkesë në muajin qershor 2020.

Informacioni i kërkuar më sipër do të ishte një udhëzues edhe për ne si organizatë për të parë mundësinë se si mund të ofrohem për ndihmë në këto kohë të vështira dhe të pazakonta për të gjithë.

Edhe pse situata është e vështirë, duhet të kemi parasysh të gjithë që komuniteti e ka të nevojshëm informacionin e saktë, sjelljen me dinjitet kundrejt tyre dhe mbështetjen ekonomiko - sociale.

Duke ju uruar punë të mbarë në menaxhimin dhe përballimin e kësaj fatkeqësie natyre, mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,